



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**

**Qeveria -Vlada - Government**

***Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural - Ministarstvo Poljoprivrede,***  
***Šumarstva i Ruralnog Razvoja - Ministry of Agriculture, Forestry And Rural***  
***Development***

Duke u bazuar në nenin 93 pika (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, neni 1.3 pika (d) Rregulloren e UNMIK-ut nr. 2001/19 të datës 13 shtator 2001 mbi Degën e Ekzekutivit të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë dhe neni 8, paragrafi 8.2 dhe 8.5 Ligjin Nr.2004/21 për Veterinarinë të datës 30.07.2004, Ministri i Ministrisë së Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural, Nxjerr sa vijon:

**UDHËZIM ADMINISTRATIV NR.27/2008**

**Për kontrollin dhe monitorimin e sëmundjes së Rinotrakeitit Infektiv dhe Diarësë Virale të Gjedhit**

**Neni 1**

**Qëllimi**

Ky udhëzim administrativ nxirret me qëllim të ruajtjes së shëndetit të kafshëve. Autoriteti kompetent përcakton masat veterinare për kontrollin dhe monitorimin e sëmundjes së Rinotrakeitit Infektiv dhe Diarësë Virale të Gjedhit - IBR dhe BVD.

**Neni 2**

**Përkufizimet**

Për kuptimin e këtij udhëzimi administrativ, termat e përdorur në te kanë këtë domethënie:

“**IBR** – Infectious Bovine Rhinotracheitis - Rinotrakeit infektiv i gjedhit” - është sëmundje virale e gjedhit e cila bartet nga kafsha në kafshë horizontalisht dhe vertikalisht;

“**BVD** – Bovine Viral Diarrhoea - Diarea Virale e Gjedhit” - është sëmundje virale e gjedhit e cila bartet nga kafsha në kafshë horizontalisht dhe vertikalisht;

“**Hulumtimet diagnostike**” - janë hulumtime të cilat bëhen përmes analizave të gjakut tek kafshët për diagnostifikim në sëmundjen IBR dhe BVD;

**“Qendra për Mbarshtimin e Kafshëve”** - është qendra në të cilën mbahen, rriten dhe selektohen kafshët nga të cilat merret materiali gjenetik, i cili ruhet dhe testohet;

**“Laboratori Veterinar dhe i Ushqimit të Kosovës”**- është organ kompetent dhe i autorizuar nga Agjencioni i Veterinarisë dhe i Ushqimit të Kosovës, respektivisht nga Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural për kryerjen e analizave të ushqimit me prejardhje shtazore, monitorimin dhe diagnostifikimin e sëmundjeve të kafshëve, ushqimit të kafshëve dhe mbetjeve të barnave veterinare;

**“Autoriteti kompetent”**- është Agjencioni i Veterinarisë dhe i Ushqimit të Kosovës,

**“Inspektori Veterinar”** - është zyrtari i Autoritetit kompetent;

**“Veterinari i autorizuar”** është veterinari i autorizuar nga Autoriteti kompetent.

### **Neni 3**

#### **Importimi i kafshëve për mbarshtim**

3.1. Në Republikën e Kosovës do të lejohet importimi i kafshëve për mbarshtim nëse plotësohen këto kushte:

i) të dëshmohet se kafshët janë të lira nga sëmundja IBR dhe BVD;

ii) të dëshmohet se kafshët janë të vaksinuara me vaksinë të markuar.

3.2. Kafshët nga paragrafi 3.1, pika ii) të këtij neni, duhet të posedojnë dëshmi nga laborator i autorizuar se janë të vaksinuara me vaksinë të markuar në 30 ditët e fundit para se të bëhet eksporti i tyre dhe se duhet të dëshmohet se vakcina e markuar është e aprovuar nga autoriteti kompetent i shtetit eksportues.

3.3. Autoriteti kompetent, në rast dyshimi mund të bëjë verifikimin e analizave në laboratorët e autorizuar brenda apo jashtë vendit.

3.4. Me të arritur të dërgesës, e njëjta vendoset në karantinë dhe ndaj saj zbatohen dispozitat e Udhëzimit Administrativ MA-Nr. 19/2006 për vendosjen e kafshëve të gjalla në karantinë.

3.5. Në rast se kafshët nga paragrafi 3.1, pika i) të këtij neni, gjatë qëndrimit në karantinë pas hulumtimit diagnostik në laboratorin e autorizuar rezultojnë të infektuara ose të sëmura i këthehen eksportuesit, ndërsa nëse kjo nuk është e realizueshme, atëherë dërgohen në therje të dhunshme apo asgjësohen.

3.6. Në rast se dërgesa e cila është në karantinë, pas hulumtimeve diagnostike rezulton pozitive si pasojë e vaksinës së markuar, por që vakcina është në përputhje me standardet e Bashkësisë Evropiane, atëherë Autoriteti kompetent e lejon shpërndarjen e dërgesës.

3.7. Shpenzimet e krijuara me rastin e qëndrimit të kafshëve në karantinë, shpenzimet e hulumtimeve diagnostike, të përkujdesjes veterinare, të transportit, të këthimit, të therjes së dhunshme apo asgjësimit, i bartë subjekti i cili i importon kafshët.

### **Neni 4**

#### **Importimi i materialit gjenetik**

4.1. Në Republikën e Kosovës, Autoriteti kompetent mund të lejojë importimin e materialit gjenetik, materialit biologjik për riprodhim (spermës, ovulave dhe embrioneve) në rast se dërgesa është e pajisur me certifikatën për kryerjen e analizave laboratorike e cila dëshmon se kafsha nga shteti eksportues është e lirë nga sëmundjet IBR dhe BVD.

4.2. Nuk lejohet importimi i materialit biologjik për riprodhim – spermës, ovulave dhe embrioneve, të marrura nga kafshët e vaksinuara, infektuara apo të sëmura nga BVD dhe IBR.

#### **Neni 5**

#### **Materiali gjenetik i prodhuar në Qendrën për mbarshtim**

Qendra për mbarshtim të kafshëve e cila merret me rritjen e kafshëve nga të cilat bëhet marrja e materialit gjenetik për mbarsim artificial duhet t'i testojë kafshët për praninë e sëmundjeve IBR dhe BVD së paku dy herë në vit.

#### **Neni 6**

Demat për mbarsim natyral në kuadër të fermave komerciale dhe të fermave në ekonomitë familjare, përveç që duhet të jenë të testuar për sëmundjen IBR dhe BVD, duhet që të jenë të evidentuar në Qendren për Mbarshtimin e kafshëve.

#### **Neni 7**

Demat të cilët rezultojnë pozitiv në sëmundjen IBR dhe BVD nuk mund të shërbejnë për mbarsim dhe si të tillë kastrohen ose dërgohen në therrje të dhunshme dhe fshihen nga evidenca zyrtare e qendres.

#### **Neni 8**

#### **Zbatimi**

8.1. Për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ, Autoriteti kompetent harton formën e certifikatës veterinare për importin e kafshëve të gjalla dhe materialit gjenetik.

8.2. Për zbatimin e këtij udhëzimi administrativ, kryeshefi ekzekutiv i autoritetit kompetent do të nxjerr vendime.

8.3. Moszbatimi i dispozitave të këtij udhëzimi administrativ do të sanksionohet sipas nenit 45 të Ligjit për Veterinarinë Nr.2004/21 të datës 30 korrik 2004 dhe dispozitave ligjore në fuqi.

#### **Neni 9**

#### **Hyrja në fuqi**

Ky udhëzim administrativ hyn në fuqi 30 ditë pas nënshkrimit.

Prishtine \_\_\_\_\_ 2008

Ministria e Bujqësisë, Pylltarisë dhe Zhvillimit Rural  
Ministri,  
Idriz Vehapi